




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	03-02/DPK	Nr Prot	01-1606/16
Dep.		B: Prot	
U-p.		Prot No	
Nr. Esh.		Data	
Broj. Paranca	02	Datum	26.04.2016
Nr. paze:		Date	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.04.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3476/15, për z. Mahir Yagcilar - Ministër në Ministrinë e Administratës Publike, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Mahir Yagcilar - Ministër në Ministrinë e Administratës Publike, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Mbështetja financiare e bërë nga Ministria e Administratës Publike për pesë organizata joqeveritare, të drejtura nga anëtar të partisë turke KDTP, pjesë e të cilit është edhe Ministri Yagcilar është parë si situatë e dyshuar për konflikt interesi.

Prandaj, Zyrtari i lartë z. Yagcilar është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar një takim me zyrtarin e lartë, me këtë rast z. Yagcilar, është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit për gjendje të mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Yagcilar gjatë këtij takimi ka deklaruar se subvencionimi i organizatave joqeveritare është bërë në përputhje me Rregulloren nr.01/2014 për shpërndarjen e subvencioneve për organizata joqeveritare.

Po ashtu, z. Yagcilar ka deklaruar se me asnjërin prej drejtuesve të këtyre Organizatave joqeveritare nuk ka lidhje familjare që Ligji e njeh si nocion “person i afërt me zyrtarin e lartë”.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm lidhur me rastin dhe po ashtu ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI -03-02-626/16), me të cilën është vërtetuar statusi i drejtuesve të këtyre pesë organizatave joqeveritare, që kanë në partinë politike KDTP.

Sipas kësaj shkrese të pranuar në Agjenci, pesë përfituesit e organizatave joqeveritare janë anëtar të partisë së KDTP.

Pas shqyrtimit të fakteve të siguruara nga Agjencia është vërtetuar se nuk ka shkelje të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtarit të lartë i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të ketë parasysh gjithnjë deklarin rast për rast të interesave private të zyrtarit të lartë, neni 13 (paragrafi 1,2,3), të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

